



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:138220

Datë: 09.02.2024

Numri i dokumentit: 05306131

P.nr 2121/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË -Departamenti i Përgjithshëm, më gjyqtarin Sabit Sadikaj, me Bashkëpunëtorin Profesional Asdren Selmani, në çështjen penale kundër të pandehurës E.K, si dhe F.G, për shkak të veprës penale “Lëndimi i lehet trupor” nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së , sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti të Përgjithshëm Penal, PP/II NR. 7486/18, i datës 25.06.2019 në mbështetje të nenit 357 par.1, pika 1.3 të KPPRK-së, jashtë seancës dhe sipas detyrës zyrtare me datë: 08.02.2024, mori këtë

A K T V E N D I M

- I. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë- Departamenti Të Përgjithshëm Penal PP/II Nr. 7486/18, i datës 25.06.2019, si dhe
- II. PUSHOHET procedura kundër të pandehurve E.K e bija nga i ati A dhe nënës Sh e gjinisë H e lindur më datë: “data e lindjes”, në Fshatin “emri i fshatit”, më adrese banimi rr “Emri i rrugës” kati i “Nr. i katit” nr.... Prishtinë, më numër personal “letërnjoftim”, e martuar e gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetase e Republikës se Kosovës, si dhe F.G nga i ati B dhe nënës A e gjinisë P i lindur më datë: “data e lindjes” në Prishtinë me adrese banimi në Lagjen “Lagja”, me numër personal “letërnjoftim”, i martuar ,shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës.
- III. Për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale për veprën penale “Lëndimi i lehet trupor” nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së .
- IV. Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrë mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti përgjithshëm Penal ka ngritur aktakuzë PP/II.Nr.7486/18,i datës 25.06.2019, kundër të pandehurve: K.K, E.K, F.G, si dhe B.G, për shkak të veprës penale “Lëndimi i lehet trupor” nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së

Gjykata ka marrë aktvendimin P.nr.2121/19, me dt: 08.02.2024, për veçim e procedurës, ndaj të pandehurave K.K, A.G, dhe B,G behet veçimi i procedurës penale ndaj tyre lënda do te merr numër te ri.

Gjykata pas ka bere analizimin e aktakuzës, ka konstatuar se ndaj te akuzuarve E.K dhe F,G, ka arritur parashkrimin absolut i ndjekjes penale për veprën penale “ Lëndim i lehtë trupor” nga neni 188 par1 par 1.4 të KPPRK-së, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, prandaj duke vlerësuar se parashkrimi është një rrethanë e cila e pengon ndjekjen e mëtejme penale ndërsa mbi bazën e këtyre arsyeve vendosi qe të hedhe aktakuzën dhe të pushoj procedurën penale ndaj të pandehurve të lartcekur për veprën penale “Lëndimi i lehet trupor” nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Pas shqyrtimit të lëndës, është konstatuar se në mbështetje të dispozitave nga neni 106 dhe 107 të Kodit Penal të Republikës Kosovës, ndalohet ndjekja e mëtutjeshme penale ndaj të akuzuarit, pasi që kanë kaluar afatet e caktuara ligjore nga koha e kryerjes së veprës penale, pasi që kemi të bëjmë me parashkrim, në rastin konkret për veprat penale “Lëndimi i lehet trupor” nga neni 188 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, nuk mund të ndërmerret ndjekja penale pasi që kanë kaluar afatet ligjore për ndërmarrjen e veprimeve. Për veprën penale kryerësi dënohet me burgim deri në një (1) vjet, kurse në bazë të nenit 106 par.1.6 të KPP-së, “*ndjekja penale nuk mund te ndërmerret nëse kanë kaluar afatet si më poshtë*”, ku sipas nën par. 1.6, i po këtij neni është “*dy vite për veprat penale të dënueshme deri në një vit burgim;*”, që nënkupton se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret pasi që kanë kaluar mbi 2 vite, ndërsa sipas nenin 107 par. 8 te KPRK-së “*ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale)*, andaj në lidhje me kohën e dyshimit të kryerjes së kësaj vepre penale me datë: 01.12.2018, e lidhur me nenin 106 par.1 nën par. 1.6 e lidhur me nenin 107 par. 8 te KPRK-së, në këtë rast penal, kemi parashkrim absolut të ndjekjes penale, pasi që ka kaluar më shumë së (4) vite nga koha e kryerjes së veprës penale. Parashkrimi absolut në këtë rast penal ka arritur me datë:02.12.2022, pasi që brenda kësaj periudhe kohore, nuk ka përfunduar ndjekja penale.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 357 par. 1 nenpar.1.3 të KPPK-së, e hedhe aktakuzën dhe e pushoj procedurën e mëtutjeshme penale ndaj të akuzuarit dhe atë, duke u bazuar në nenin 106 par.1 nën par.1.6, e lidhur me nenin 107 par.8 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Mbi shpenzimet e procedurës penale është vendosur ne bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-së.

Nga të cekurat me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 2121/19, të datë:08.02.2024

Bashkëpunëtori Profesional
Asdren Selmani

G j y q t a r i
Sabit Sadikaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 (tri) ditësh prej ditës së pranimit të te njëjtit, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.